


# Taksat e Mjedisit në Shqipëri

## Viti 2016

**Tiranë, më 11 Korrik 2018:** Në 2016, të ardhurat nga taksat mjedisore arritën në vlerën e rreth 48 miliardë lekë, duke pësuar rritje me 8,64 % krahasuar me vitin 2015, ndikuar kjo kryesisht nga rritja e të ardhurave nga taksat e transportit.

Fig. 1 Të ardhurat nga taksat mjedisore



Tab 1. Të ardhurat nga taksat mjedisore sipas llojeve

(milionë lekë)

Viti	2012	2013	2014	2015	2016
Taksat e Energjisë	24.578	25.057	27.312	22.924	24.539
Taksat e Transportit	10.290	10.461	14.892	19.255	21.342
Taksat e Ndotjes	1.878	1.853	1.889	1.782	1.880
Taksat e Burimeve Natyrore	9	11	14	19	16
<b>Gjithsej</b>	<b>36.755</b>	<b>37.383</b>	<b>44.107</b>	<b>43.980</b>	<b>47.778</b>

Nga struktura e të ardhurave të taksave mjedisore për vitin 2016, taksat e energjisë zënë pjesën më të madhe të të ardhurave me 51,36 %, të shoqëruar nga taksat e transportit 44,67 %, taksat e ndotjes me 3,93 % dhe taksat e burimeve natyrore me 0,03 %.

Në vitin 2016, krahasuar më një vit më parë, të ardhurat nga taksat e transportit janë rritur me 10,84 %, të ardhurat nga taksat e energjisë dhe taksat e ndotjes janë rritur me 7,05 % dhe 5,49 %, ndërkohë të ardhurat nga taksat e burimeve natyrore janë ulur me 14,33 %.

**Tab 2. Struktura e të ardhurave nga taksat mjedisore sipas llojeve**

(%)

Viti	2012	2013	2014	2015	2016
Taksat e Energjisë	66,87	67,03	61,92	52,12	51,36
Taksat e Transportit	28,00	27,98	33,76	43,78	44,67
Taksat e Ndotjes	5,11	4,96	4,28	4,05	3,93
Taksat e Burimeve Natyrore	0,03	0,03	0,03	0,04	0,03

Në 2016, pesha e të ardhurave nga taksat mjedisore ndaj PBB është 3,24 %, duke pësuar një rritje me 0,17 %, krahasuar me 2015.

Të ardhurat nga taksat mjedisore, në vitin 2016, përbëjnë 12,92 % të totalit të të ardhurave tatimore dhe kontributeve shoqërore duke pësuar një rritje me 0,07 % krahasuar me 2015.

**Tab 3. Të ardhurat tatimore mjedisore**

(%)

Viti	2012	2013	2014	2015	2016
Pesha që zënë të ardhurat e taksave mjedisore ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto(PBB)	2,76	2,77	3,16	3,07	3,24
Pesha që zënë të ardhurat e taksave mjedisore ndaj taksave në total dhe kontributeve shoqërore	12,22	12,47	13,13	12,85	12,92

2015\* Finale PBB

2016\*\* Gjysmë-finale PBB

# Shënime metodologjike

## Përkufizime

### Llogaritë e taksave të lidhura me mjedisin

Taksat mjedisore konsiderohen si një instrument ekonomik për të kontrolluar ndotjen dhe menaxhimin e burimeve natyrore dhe ato janë konceptuar për të ndikuar në sjelljen e bizneseve, prodhuesve dhe konsumatoreve. Taksat mjedisore janë pjesë e llogarive ekonomike në mjedis, pjesë e një sistemi satelitor të llogarive kombëtare.

Të dhënat e taksave mjedisore janë siguruar nga Ministria e Financës. Të dhënat e taksave të energjisë, transportit, ndotjes, dhe burimeve janë subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: [http://www.instat.gov.al/media/2829/politika\\_e\\_revizionimit.pdf](http://www.instat.gov.al/media/2829/politika_e_revizionimit.pdf) Politika e revizionimit statistikor.

Në vazhdim janë katër grupime të mëdha të taksave të mjedisit:

### Taksat e energjisë

Taksat e energjisë (duke përfshirë karburantin e makinave) përfshijnë taksat mbi prodhimet e energjisë në vend, si dhe prodhimet e energjisë që përdoren edhe për qëllime të transportit. Këtu përfshihen edhe tatimet mbi bio-karburantet dhe format e tjera të energjisë nga burimet e rinovueshme, si dhe taksat mbi rezervat e produkteve të energjisë.

### Taksat e Transportit

Taksat e transportit (me përjashtim karburantin e makinave) i referohen kryesisht taksave të lidhura me pronësinë dhe përdorimin e automjeteve. Këto taksa përfshijnë edhe taksat mbi mjetet e tjera të transportit (si avionët, anijet dhe trenat, etj.) dhe shërbimet e tyre.

### Taksat e Ndotjes

Taksat e ndotjes përfshijnë emetimet e matura në ajër dhe shkarkimet në ujë, menaxhim të mbetjeve të ngurta dhe zhurmës etj. Përfshihen këtu tatimi mbi emetimin e CO<sub>2</sub>, i cili mbulohet nga kategoria taksave të energjisë.

**Taksat e Burimeve Natyrore**

Taksat e burimeve natyrore përfshijnë taksat për nxjerrjen apo shfrytëzimin e burimeve natyrore (ujë, pyje, kafshë të egra, etj)

TVSH dhe taksat e tjera nuk përfaqësojnë një taksë me ndikim direkt parandalues ose frenues të produkteve që dëmtojnë mjedisin, si dhe nuk përdoret në forme ekskluzive për mbrojtjen e mjedisit. Si rezultat këto taksa janë të përjashtuara nga këto vlerësime.

Lista kombëtare e taksave paraqet pikënisje për vlerësimin e të ardhurave nga taksat mjedisore. Metodologjia e përdorur për llogaritjen e tyre është bërë në përputhje me Rregulloren (BE) Nr 691/2011 dhe udhëzimet e Eurostat: "Taksat mjedisore, një udhëzues statistikor". Këto të dhëna janë të harmonizuara me Sistemin Evropian të Llogarive Ekonomike (ESA 2010).